

4. ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE GJATË GJYSMËS SË PARË TË VITIT 2011³⁶

SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE ME VLERË TË MADHE - AIPS

Në pjesën e parë të vitit 2011, në sistemin AIPS është realizuar një vëllim prej 37,045 transaksionesh, me një vlerë totale të likuiditetit të qarkulluar prej 1,873 miliardë lekësh dhe një vlere mesatare për transaksion prej 50.5 milionë lekësh. Kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, numri i transaksioneve të shlyera gjatë vitit 2011, rezulton të jetë rritur me 3.9%, ndërsa vlera e transaksioneve të shlyera është ulur me 12.4%. Mesatarisht, çdo ditë në sistemin AIPS janë procesuar dhe shlyer rreth 292 transaksione me një qarkullim mesatar ditor prej 14.75 miliardë lekësh.

Tabelë 9. Vëllimi i transaksioneve për pagesat me vlerë të madhe

Sistemi AIPS	2007	2008	2009	2010	6M I '11
Numri i transaksioneve	45,480	56,717	55,701	80,356	37,045
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	3,745	5,146	4,718	4,437	1,873
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	82	91	85	55	50.5

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë periudhës gjashtëmuajore, në sistemin AIPS janë procesuar 1,376 transaksione më shumë, ose një rritje prej rreth 4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Volumi në rritje gjatë 2-3 viteve të fundit është ndikuar prej automatizimit të pagesave të thesarit nga ana e Ministrisë së Financave, në muajin mars 2010, të cilat përbëjnë një peshë materiale si në numër dhe në vlerë, ndaj totalit të pagesave të klientëve në sistemin AIPS.

Vlen të theksohet se një numër i kufizuar bankash zënë peshën kryesore të totalit të aktivitetit në sistemin AIPS, tregues ky i nivelit të përqendrimit.

SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL - AECH

Në sistemin AECH procesohen dhe klerohen pagesat e klientëve me vlerë nën 1.5 milionë lekë. Në gjysmën e parë të vitit 2011, në sistemin AECH u kleruan 183,342 urdhërpagesa, me një vlerë mesatare të shlyer për transaksion prej 156 mijë lekësh. Mesatarisht, çdo ditë në sistemin AECH janë procesuar rreth 1,443 pagesa, me një vlerë mesatare ditore prej 225 milionë lekësh.

³⁶ Ky material është bazuar në të dhënat e përpunuara dhe në materialet e përgatitura nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Banka e Shqipërisë.

Tabelë 10. Vëllimi i transaksioneve për pagesat me vlerë të vogël

Sistemi AECH	2007	2008	2009	2010	6M I '11
Numri i transaksioneve	71,857	113,682	102,304	332,777	183,342
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	12.01	17.61	15.46	43.98	28.62
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	0.17	0.15	0.15	0.13	0.16

Burimi: Banka e Shqipërisë.

INSTRUMENTET E PAGESAVE

Në fund të muajit qershor 2011, numri i bankave të licencuara si emetuese kartash, që ofrojnë shërbimin e tërheqjes cash nga bankomatet (pajisjet ATM), ishte 14. Nga bankat që emetojnë karta, vetëm 8 banka (nga 7 në fund të vitit 2010) janë njëkohësisht të licencuara edhe si pranuese kartash, duke ofruar shërbimin e pranimit të pagesave me karta në pikat e shitjeve, nëpërmjet pajisjeve POS të vendosura në dyqane, restorante, hotele apo dhe në qendra tregtare. Në fund të gjysmës së parë të vitit 2011, numri i pajisjeve ATM dhe rrjeti i pajisjeve POS është rritur respektivisht me 2.9% dhe 1.1% në krahasim me fundin e vitit 2010.

Tabelë 11. Ecuria e numrit të ATM-ve dhe POS në fund të periudhave respektive

Numri i ATM/POS	2006	2007	2008	2009	2010	6M I '11
Numri i ATM	309	433	642	741	761	783
Numri i POS	1234	1832	2953	4,370	4,680	4.729

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës janar-qershor 2011, në total u procesuan rreth 5.6 milionë transaksione me karta (ATM dhe POS) me një qarkullim total prej 56 miliardë lekësh. Nga totali i transaksioneve, rreth 96% e përfaqësojnë tërheqjet cash nga ATM-të dhe vetëm 4% janë pagesa klientësh me karta në POS-e, tregues ky i një ekonomie ende me përdorim të lartë të cash-it.

Tabelë 12. Ecuria e numrit të kartave dhe llojit të tyre

Numri i kartave	2008	2009	2010	6M I '11
Lloji i kartave:	512,232	596,985	694,848	709,100
1- Karta Debiti	482,072	543,141	667,548	680,465
2- Karta Kreditit	15,931	23,844	27,300	28,635
Numri total i kartave në qarkullim	498,003	566,985	694,848	712,575

Burimi: Banka e Shqipërisë. Raportimi i bankave sipas metodologjisë "Për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Mbështetur në raportimet e bankave, kartat e debitit përbëjnë 96% të totalit të numrit të kartave në qarkullim, ndërsa sipas markës apo llojit të operatorëve që i procesojnë ato, kartat VISA zënë përqindjen më të madhe të totalit, prej rreth 83%, ndjekur nga MasterCard. Maestro dhe American Express përbëjnë një peshë relativisht të vogël. Vetëm dy banka emetojnë karta lokale, të cilat zënë vetëm 1.6% të totalit të kartave në qarkullim.

Home Banking është një shërbim tjetër bankar, i cili po gjen përdorim gjithnjë e më rritje, duke i mundësuar klientëve përdorimin në distancë të llogarive bankare, nëpërmjet një linje interneti, linje telefoni apo një software-i që banka i vë në dispozicion klientit të saj. Në vendin tonë, ky shërbim

u ofrua për herë të parë në vitin 2005, ndërsa në vitin 2011 ofrohet nga 11 banka. Gjatë pjesës së parë të vitit 2011 janë raportuar rreth 86 mijë transaksione elektronike "Home Banking" për të gjithë sistemin bankar, me një vlerë totale prej 46.16 miliardë lekësh. Në gjysmën e parë të vitit 2011, transaksionet elektronike "Home Banking" kanë shënuar rritje respektivisht prej 11% në numër dhe 13% në vlerë.